


VAC 1s

Manuali i përdorimit

SQ | 200004300v01 | 2025-01



eIFU:
<https://www.metasys.com/download-area/?lang=en>






METASYS
protect what you need

Tabela e përmbajtjes

| | | |
|-----------|--|-----------|
| 1. | Udhëzime | 4 |
| 1.1. | Udhëzimet e përgjithshme | 4 |
| 1.2. | Shpjegimi i simboleve | 4 |
| 1.3. | Udhëzim për të drejtën e autorit | 5 |
| 2. | Qëllimi i përdorimit | 6 |
| 2.1. | Indikimi | 6 |
| 2.2. | Kundërrindikimi | 6 |
| 2.3. | Përdoruesi i synuar | 6 |
| 3. | Informacionet për sigurinë | 7 |
| 3.1. | Udhëzimet e përgjithshme për sigurinë | 7 |
| 3.2. | Udhëzimet e sigurisë | 7 |
| 3.3. | Udhëzimet paralajmëruese | 7 |
| 3.4. | Rreziqet dhe efektet anësore | 7 |
| 4. | Përshkrimi i produktit | 8 |
| 4.1. | Përshkrimi i produktit | 8 |
| 4.2. | Specifikimet teknike / Specifikimet e performancës | 8 |
| 4.3. | Etiketa e tipit | 8 |
| 4.4. | Ndërtimi | 9 |
| 4.5. | Përshkrimi i funksionimit | 9 |
| 5. | Parapërgatitja për përdorimin | 10 |
| 5.1. | Transporti dhe ruajtja | 10 |
| 5.2. | Kushtet paraprake të instalimit | 10 |
| 5.2.1. | Lidhjet e tubave dhe tubacioneve | 11 |
| 5.3. | Instalimi, montimi dhe vënia në punë | 11 |
| 5.3.1. | Instalimi dhe montimi i aksesorëve dhe pjesëve të këmbimit | 13 |
| 5.3.1.1. | Lidhja e kutisë së komandimit | 14 |
| 5.3.1.2. | Montimi i ndarësit të ujit të kondensuar | 15 |
| 5.3.2. | Lidhja e pajisjeve të tjera | 15 |
| 5.4. | Sistemi elektronik | 16 |
| 5.4.1. | Lidhjet elektrike | 16 |
| 5.4.2. | Skema e qarkut | 16 |
| 6. | Përdorimi | 17 |
| 6.1. | Funksionimi normal | 17 |
| 6.2. | Mesazhet e defekteve | 18 |
| 7. | Kujdesi dhe mirëmbajtja | 18 |
| 7.1. | Mirëmbajtja dhe shërbimi | 18 |
| 8. | Nxjerrja jashtë shërbimi | 19 |
| 8.1. | Çmontimi | 19 |
| 8.2. | Riciklimi dhe asgjësimi | 19 |
| 9. | Shtojca | 20 |
| 9.1. | Numrat e porosive dhe qëllimi i dorëzimit | 20 |
| 9.1.1. | Aksesorët, setet e shërbimit, depozita mbledhëse dhe pjesët e këmbimit | 20 |
| 9.2. | Kushtet e garancisë | 21 |
| 9.3. | Historia e ndryshimit | 21 |

eIFU

| | | |
|---|---|---|
|  |  | eIFU: https://www.metasys.com/download-area/?lang=en |
| |  | DE, EN, FR, IT, CS, EL, ES, HU, PL, RO, SQ, TR |
| | Email | ifu@metasys.com |
| | Kodi i porositjes | 200004300v01 |

Manuali i përdorimit në format elektronik (eIFU) mund të shkarkohet në www.metasys.com/download-area/?lang=en. Dokumentin e dëshiruar mund ta gjeni duke përdorur filtrin e kërkimit.

Manuali eIFU ofrohet në format PDF. Për ruajtjen dhe printimin e skedarëve PDF ju nevojitet një lexues PDF, si për shembull Adobe Acrobat Reader që mund të merret falas.

Nëse dëshironi të porositni një kopje të printuar të manualit të përdorimit, jeni të lutur të na kontaktoni në ifu@metasys.com ose përdorni formularin e porosities në www.metasys.com/downloads. Manuali i përdorimit në formë të printuar në letër ju vihet në dispozicion pa pagesë dhe brenda shtatë ditëve kalendrike pas marrjes së kërkesës.

Përkthime

Përkthim i instruksioneve origjinale të përdorimit



Tetras GmbH

Sirius Business Park, Rupert-Mayer-Str. 44, 81379 Munich, Germany

Figurat

Figurat e përfshirë në këtë manual përdorimi shërbejnë vetëm si referencë dhe mund të ndryshojnë nga pamja reale e produktit.

1. Udhëzime



























1.1. Udhëzimet e përgjithshme















Siguria, besueshmëria dhe performanca e pajisjeve dentare garantohet nga METASYS vetëm atëherë kur ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

- > Produkti përdoret vetëm në përputhje me manualin e përdorimit.
- > Në punimet e mirëmbajtjes dhe shërbimit (inspektimi, shërbimi, riparimi, ndërrimi) përdoren vetëm pjesë këmbimi origjinale.
- > Respektohen të gjitha specifikimet e prodhuesit të njësive të trajtimit që lidhen në pajisje.
- > Pas vënies në punë plotësoni vërtetimin e montimit dhe dërgojeni te METASYS, për të përcaktuar periudhën e garancisë.
- > Çdo punim mirëmbajtjeje dhe shërbimi duhet regjistruar në dokumentacionin e pajisjes.
- > Pas kërkesës nga një teknik i autorizuar, METASYS pranon të vendosë në dispozicion të gjithë dokumentacionin që është i nevojshëm për personelin e kualifikuar teknik për punimet e mirëmbajtjes dhe shërbimit.
- > METASYS nuk pranon asnjë përgjegjësi për dëmet si pasojë e ndikimeve të jashtme (instalimi me të meta), e përdorimit të informacioneve të gabuara, përdorimit jo sipas rregullave të pajisjes dentare ose për shkak të punimeve të mirëmbajtjes dhe shërbimit të kryera në mënyrë të pasaktë.
- > Përdoruesi duhet të familjarizohet me përdorimin e pajisjes dentare dhe të sigurohet për gjendjen e rregullt të pajisjes dentare përpara çdo përdorimi të saj.

E rëndësishme: Lexoni plotësisht me kujdes dokumentacionin e pajisjes përpara instalimit, vënies në punë dhe përdorimit, dhe ruajeni atë për të gjithë jetëgjatësinë e produktit.

1.2. Shpjegimi i simboleve

| | | | |
|---|---|---|--------------------------------------|
|  | Markimi CE |  | Subjekti përgjegjës për përkthimin |
|  | Pajisje mjekësore |  | Pjesë e aplikuar e tipit B |
|  | Identifikues unik i një pajisjeje mjekësore |  | Shiko manualin e përdorimit |
|  | Shënimi UDI me përmbajtjen e të dhënave HIBC në përputhje me standardin |  | Përdor doreza |
|  | Numri i artikullit |  | Përdor mbrojtje për sytë |
|  | Numri i serisë |  | Përdor mbrojtje për gojën dhe hundën |
|  | Prodhuesi |  | Tokëzo përpara përdorimit |
|  | Data e prodhimit |  | Hiq spinën elektrike |
|  | Emri dhe adresa e zyrës së regjistruar të përfaqësuesit të autorizuar në Zvicër |  | Simbol paralajmërues i përgjithshëm |
|  | Shiko manualin e përdorimit |  | Paralajmërim për tension elektrik |
|  eIFU: https://www.metasys.com/download-area/?lang=en | Shiko manualin e përdorimit me referim tek eIFU |  | Paralajmërim për sipërfaqe të nxehtë |
|  | Kufi i temperaturës |  | Paralajmërim për lëndët shpërthyesë |
|  | Vëmendje / Kujdes |  | Paralajmërim për rrezikun biologjik |

| | | | |
|---|--|---|---|
|  | Kujdes - Goditje nga rryma elektrike |  | Mbro nga nxehtësia / Mbro nga drita e diellit |
|  | Kufi i lagështisë së ajrit |  | Mbro nga lagështia / Ruaje në vend të thatë |
|  | Lartësia maksimale e instalimit mbi nivelin e detit |  | E thyeshme |
|  | Ventilator |  | Drejtimi i paketimit lart |
|  | Ndezur Fikur |  | Kufizim për stivosjen n = (numri) |
|  | Grumbullim i veçuar i pajisjeve elektrike dhe elektronike WEEE |  | Informacion |
|  | Tokëzim mbrojtës |  | Shkarkim |

1.3. Udhëzim për të drejtën e autorit

Të gjithë emrat dhe të dhënat në dokument mbrohen nga ligjet për të drejtën e autorit. Transferimi, shumëfishimi ose çdo përdorim tjetër i këtij dokumenti lejohet vetëm me miratimin me shkrim nga kompania METASYS Medizintechnik GmbH.

2. Qëllimi i përdorimit

Pajisja thithëse VAC 1s është një sistem thithës qendror për përdorim në klinikat dentare, për prodhimin e ajrit qendror të thithjes.

2.1. Indikimi

Nuk aplikohet.

2.2. Kundërindikimi

Nuk aplikohet.

2.3. Përdoruesi i synuar

Pajisja lejohet të përdoret vetëm nga personel shëndetësor me formim në fushën e stomatologjisë. Instalimi, punimi e mirëmbajtjes dhe shërbimit duhen kryer vetëm nga teknikët e trajnuar nga METASYS.

3. Informacionet për sigurinë

3.1. Udhëzimet e përgjithshme për sigurinë

Të gjitha incidentet e rënda që kanë ndodhur në lidhje me produktin duhet t'i njoftohen prodhuesit dhe autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar në të cilin është i vendosur përdoruesi dhe/ose pacienti.

3.2. Udhëzimet e sigurisë



PARALAJMËRIM:

Ky produkt është një pajisje elektro-mjekësore (ME), me furnizim të jashtëm me energji, klasa I, sipas standardit EN 60601-1: Për të shmangur rrezikun e një goditjeje elektrike, pajisja duhet të lidhet vetëm në një rrjet furnizimi me përcjellës mbrojtës tokëzimi.

RREZIK:

Ndalohet përdorimi në ambientet me rrezik shpërthimi dhe zjarri!

Montimi, ndryshimet ose riparimet lejohen të kryhen vetëm nga personeli teknik i autorizuar, i cili garanton respektimin e standardit EN 60601-1 (standardi ndërkombëtar për pajisjet elektro-mjekësore, në veçanti Pjesa 1: Përcaktimet e përgjithshme për sigurinë).

Instalimi elektrik duhet realizuar në përputhje me përcaktimet nga IEC (Komisioni Ndërkombëtar i Elektroteknikës).

3.3. Udhëzimet paralajmëruese

| | |
|---------------------|---|
| RREZIK | Paralajmërim për një rrezik që çon drejtpërdrejt në lëndime të rënda ose vdekje |
| PARALAJMËRIM | Paralajmërim për një rrezik që mund të çojë në lëndime të rënda ose vdekje |
| VËMENDJE | Paralajmërim për një rrezik që mund të çojë në lëndime të lehta |
| KUJDES | Paralajmërim për një rrezik që mund të çojë në dëme materiale të mëdha |

3.4. Rreziqet dhe efektet anësore




| Mesazhi i defektit | Shkaku i mundshëm | Veprimet korrigjuese |
|--------------------|----------------------------|---------------------------|
| Rreziqet | Qarku elektronik me defekt | Funksioni kryesor dështon |
| | Motori me defekt | Funksioni kryesor dështon |
| Efektet anësore | jo relevante | jo relevante |

4. Përshkrimi i produktit

4.1. Përshkrimi i produktit

VAC 1s është një sistem thithës në të thatë për një vend të vetëm, për përdorim në 1 njësi trajtimi dentar.


4.2. Specifikimet teknike / Specifikimet e performancës



| | VAC 1s, 50 Hz | VAC 1s, 60 Hz |
|-----------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Ushqimi elektrik | 230 V AC | 230 V AC |
| Frekuenca | 50 Hz | 60 Hz |
| Thithja maksimale e rrymës | 3,5 A | 4,5 A |
| Fuqia maksimale | 0,55 kW | 0,63 kW |
| Temperatura maksimale e ambientit | 35 °C | 35 °C |
| Vëllimi thithës | 1000 l/min | 1000 l/min |
| Diapazoni i vakuumit i rregulluar | 120 mbar | 140 mbar |
| Kohëzgjatja e ndezjes | 100% | 100% |
| Pesha | 11 kg | 11 kg |
| Niveli i zhurmës | 53 db(A) | 56 db(A) |
| Përmasat (H x B x T) | 280 x 245 x 244 mm | 280 x 245 x 244 mm |
| Klasa e mbrojtjes | IP 54 | IP 54 |
| Klasa | Pajisje mjekësore Klasa 1 | Pajisje mjekësore Klasa 1 |

4.3. Etiketa e tipit

Etiketa e tipit ndodhet në anën e jashtme të pajisjes thithëse.



- 1 Emërtimi i pajisjes
- 2 Numri i artikullit
- 3 Numri i serisë
- 4 Të dhënat e lidhjes
- 5 Data e prodhimit
- 6 Prodhuesi
- 7 Shiko manualin e përdorimit
- 8 Pjesë e aplikuar e tipit B
- 9 Tokëzim mbrojtës
- 10 Markimi CE
- 11 Pajisje mjekësore
- 12 Grumbullimi i veçuar i pajisjeve elektrike dhe elektronike WEEE
- 13 Emri dhe adresa e zyrës së regjistruar të përfaqësuesit të autorizuar në Zvicër
- Identifikues unik i një pajisjeje mjekësore,
- 14 Shënimi UDI me përmbajtjen e të dhënave HIBC në përputhje me standardin

4.4. Ndërtimi

Pajisja thithëse

Pajisja thithëse është një krijuese vakuumi që punon në të thatë, me pompë me kanale anësore. Për ndarjen nga rryma e ajrit e lëngjeve dhe lëndëve të ngurta të thithura, në njësinë dentare nevojitet një njësi ndarëse shtesë!




Kutia e komandimit (plotësohet si opsion)

Kutia e komandimit përmban të gjithë komponentët elektrikë për komandimin dhe monitorimin e pajisjes thithëse.



Ndarësi i ujit të kondensuar (plotësohet si opsion)

Ndarësi i ujit të kondensuar shërben për mbledhjen e ujit të formuar nga kondensimi i mundshëm në linjën e thithjes përpara pajisjes thithëse. Ky mund të plotësohet më pas në pajisje si opsion.



4.5. Përshkrimi i funksionimit

Procesi i thithjes fillon kur një nga tubat e thithjes në raftin e tubave të thithjes në njësinë e trajtimit ngrihet lart. Krijimi i vakuimit bëhet bazuar në parimin e funksionimit të një kompresori me kanale anësore.



Helika është e montuar direkt në boshtin e motorit dhe së bashku me kasën e krijuar me formë të veçantë krijon në kanal anësor. Rrotullimi i helikës shkakton thithjen e ajrit. Në kanalin anësor ndodh transferimi i energjisë kinetike i helikës që rrotullohet në ajrin e thithjes, si rezultat i së cilës krijohet ngjeshja e ajrit të thithur. Pas një rrotullimi ajri i ngjeshur i thithjes transportohet më tej dhe më pas ngjishet përsëri dhe në fund shkarkohet. Kjo çon në një diferencë të lartë presioni dhe si rezultat krijohet vakuumi.

Grimcat e mëdha në fillim duhen filtruar në një parafiltrë (p.sh. në raftin e tubave të kontaktit), në mënyrë që të shmangen depozitimet në pajisjen thithëse. Rryma e thithjes më pas kalon përmes një njësie ndarëse (zakonisht në njësinë e trajtimit), e cila ndan ajrin nga pjesët e ngurta dhe të lëngshme në rrymën e thithjes. Pas njësisë së ndarjes, pajisja thithëse përçon vetëm një rrymë ajri të thatë.





5. Parapërgatitja për përdorimin

5.1. Transporti dhe ruajtja


Pajisja dërgohet e futur në kuti kartoni me dy pjesë polisteroli që gjenden brenda saj. Për transportimin e mëtejshëm dhe kthimin e mundshëm duhet përdorur ambalazhi origjinal. Pajisja duhet transportuar dhe duhet mbajtur gjithmonë në pozicion vertikal. Pajisja duhet transportuar në vendin e instalimit në gjendje plotësisht të paketuar. Pas nxjerrjes nga paketimi duhet kontrolluar tërësia e pajisjes, si dhe për dëmtime të mundshme nga transporti.




5.2. Kushtet paraprake të instalimit



- > Instalojeni vetëm në ambiente të thata me ajrim të mjaftueshëm (rekomandimi: ambient me ajër të kondicionuar)
- > Instalimi i pajisjes mund të kryhet në një dhomë teknike në të njëjtin kat me njësinë e trajtimit ose në një kat më të ulët
- > Vendoseni pajisjen vetëm mbi bazament të fortë, për të shmangur dridhjet e pajisjes
- > Për kalimin e tubave në anën e lidhjes duhet ruajtur një distancë nga muri minimumi 150 mm
- > Pjesa e përparme e pajisjes duhet të jetë lirisht e aksesueshme



5.2.1. Lidhjet e tubave dhe tubacioneve



| | 1 | 2 |
|--------------------------------|---------------------|---------------------------------|
| Gjatësitë e tubave të thithjes | Ø e hyrjes së ajrit | Ø e daljes së ajrit të përdorur |
| nën 5 m | 40 mm | ≥ 40 mm |
| mbi 5 m | 40 mm | ≥ 50 mm |

Kërkesat për lidhjet e tubave dhe të linjave të tubacioneve:


- > Përdorni vetëm tuba me material hermetik ndaj vakuimit (p.sh. tub shkarkimi të temperaturës së lartë nga PP, PVC-C, PVC-U, PEHD), i cili është rezistent ndaj të gjitha kimikateve të zakonshme që përdoren në klinikat dentare
- > Përdorni tuba fleksibël spiralë nga PVC ose nga material me të njëjtat vlera
- > Projekttoni tubat dhe tubacionet sa më shkurt të jetë e mundur: Linja e thithjes nuk duhet të kalojë gjatësinë maksimale prej 25 m!
- > Seksioni tërthor i rekomanduar për tubacionin është 40 mm, për të minimizuar humbjet në fuqinë e thithjes
- > Shmangni përdorimin e bërrylave 90° (rekomandimi: përdorni 2 bërryla x 45°)




- > Për arsye higjienike, si dhe për arsye të bezdisjes së mundshme nga zhurma, ne rekomandojmë që në lidhjen e daljes së ajrit të përdorur të montohet një filtër bakterial.
- > Lidhja e daljes së ajrit të përdorur duhet të jetë e drejtuar jashtë. Për këtë duhen marrë masa mbrojtëse (si për shembull, mbulesat mbrojtëse për oxhakun e ajrit), për ta mbrojtur pajisjen ose dhomën e pajisjes nga hyrja e shiut ose e ujit të kondensuar dhe nga kushtet e tjera atmosferike, si dhe për të evituar hyrjen brenda të kafshëve.

Montimi në çati

Rrjetë mbrojtëse




Llamarinë dhe rrjetë mbrojtëse



Montimi në mur

Llamarinë dhe rrjetë mbrojtëse



- > Diametri i lidhjes për daljen e ajrit të përdorur duhet të jetë më i madh ose i barabartë me diametrin e lidhjes së linjës së thithjes.



PARALAJMËRIM:

Të gjitha lidhjet e tubave duhen siguruar me fasheta për tubat!

Në të gjitha lidhjet e nxjerrjes së ajrit të përdorur duhet përdorur materiale tubash që janë rezistentë ndaj nxehtësisë (≥ 130°C)!

5.3. Instalimi, montimi dhe vënia në punë

Instalimi

Lexoni plotësisht të gjithë manualin përpara montimit dhe vënies në punë!


1




Siguroni kushtet paraprake për ambientin

shihni pikën 5.2. Kushtet paraprake të instalimit


- 2 Hiqni tapat në lidhjen e ajrit të thithjes dhe të daljes së ajrit të përdorur




- 3 Montoni tubat zgjatues në pikat e lidhjes.




- 4 Montoni këmbët prej gome.



- 5 Lidhni tubin e temperaturës së lartës (nuk përfshihet në përmbajtjen e dërgesës), lidhja e daljes së ajrit të përdorur




- 6 Instalimi i mundshëm i një shkarkimi të ujit të kondensimit (në anën e daljes së ajrit të përdorur)



- 7 Lidhja e linjës së thithjes, hyrja e ajrit

- 8 Lidhni kontaktet e raftit 1 dhe 3 me njësinë dentare (vetëm në versionin me kuti komandimi)



- 9 Lidhni pajisjen në furnizimin me energji sipas standardit EN 60601-1 (respektoni të gjitha standardet dhe rregullat e sigurisë specifike të shtetit!)



Informoni dentistin për funksionimin e produktit, përdorimin, kujdesin dhe kushtet e garancisë së tij.


10

Plotësoni vërtetimin e montimit dhe dokumentacionin e pajisjes dhe dërgojeni te METASYS (installation@metasys.com)




Vënia në punë


- 11 Në pajisjet pa kuti komandimi: Ndizni çelësin kryesor të klinikës
Në pajisjet me kuti komandimi: Ndizni çelësin kryesor të klinikës dhe çelësin kryesor të pajisjes



- 12 Tërhiqni tubin e thithjes nga rafti i tubave në njësinë e trajtimit



- 13 Kontrolloni të gjitha lidhjet e tubave dhe vendet e bashkimit të linjës së thithjes për rrjedhje



- 14 Matni vakuumin në linjën e thithjes me një aparaturë matëse të vakuimit (min. 120 mbar - maks. 180 mbar)




5.3.1. Instalimi dhe montimi i aksesorëve dhe pjesëve të këmbimit




Montimi, ndryshimet ose riparimet lejohen të kryhen vetëm nga personeli teknik i autorizuar (shihni pikën 3.2. Udhëzimet e sigurisë)! Për informacione të tjera dhe mbështetje gjatë kryerjes së riparimeve, modernizimeve, analizave të defekteve etj., në dispozicionin tuaj është edhe shërbimi teknik për klientin i kompanisë METASYS!

5.3.1.1. Lidhja e kutisë së komandimit


1 Përbajtja e dërgesës




2 Parapërgatitja për punë




3 Futni kabllon e motorit




4 Lidhni kabllon e motorit (kabloja blu te MN, kabloja kafe te ML)



5 Lidhni përcjellësin mbrojtës të tokëzimit




6 Mbyllni kapakun e kutisë së komandimit, futni dhe mbërtheni vidat në vrimat përkatëse.




7 Për informacione të tjera shihni edhe pikën 5.4 Sistemi elektronik.

5.3.1.2. Montimi i ndarësit të ujit të kondensuar


Emërtimet e pjesëve




- 1 Vendosi në pozicion ndarësin e ujit të kondensuar.



- 2 Mbërtheni ndarësin e ujit të kondensuar me 2x vidat dhe 2x rondelat sustë.



- 3 Fiksoni tubin me ndihmën e fashetave për tuba.



5.3.2. Lidhja e pajisjeve të tjera

Kur pajisja METASYS lidhet në pajisje apo në sisteme të tjera, mund të lindin rreziqe. Për rrjedhojë, duhet të siguroheni që nuk lind asnjë rrezik për përdoruesin ose për pacientët dhe që nuk do të ketë asnjë ndikim në mjedis. Zbatoni rregullat e prodhuesit të pajisjes ose të sistemit që do të lidhet.

5.4. Sistemi elektronik

Lidhja elektrike duhet të realizohet vetëm nga teknik elektrikist. Instalimi elektrik duhet realizuar në përputhje me rregullat lokale në fuqi. Përpara lidhjes në rrjetin elektrik, duhet krahasuar tensioni nominal në etiketën e tipit të pajisjes me tensionin elektrik të rrjetit.

5.4.1. Lidhjet elektrike

Lidhja me rrjetin elektrik

Sipas standardit EN 60601-8.11.3, ndërrimi i kordonit elektrik lejohet të bëhet vetëm nga një person i autorizuar.

Makina thithëse kontrollon nëpërmjet komanduesit në kutinë e kontrollit të jashtëm.

KUJDES:

Lidhja elektrike duhet kryer duke ndjekur rregullat e sigurimit teknik për ngritjen e pajisjeve të tensionit të ulët që përdoren në fushën e mjekësisë.



RREZIK:

Pajisja thithëse duhet lidhur në furnizimin me energji elektrike vetëm me kordonin elektrik të dërguar.

Nuk lejohet përdorimi i kablove elektrike zgjatuese!



RREZIK:

Kordoni elektrik i motorit duhet shtrirë në mënyrë të tillë që të mos ketë asnjë kontakt me sipërfaqet e nxehta

Mbrojtja e qarkut të rrjetit elektrik (vetëm në pajisjet me kuti komandimi)


Automat mbrojtës 16 A, karakteristika C sipas standardit EN 60898

Çelësi kryesor (vetëm në pajisjet me kuti komandimi)


Lidhja në rrjetin elektrik (230 V) duhet realizuar pas çelësit kryesor të klinikës. Pajisja thithëse komandohet me anë të sistemit elektronik të ndjeshëm që ndodhet në kutinë e komandimit. Pajisja e komandimit duhet vendosur në mënyrë të tillë që çelësi ndërprerës të jetë lehtësisht i arritshëm. Kutia e komandimit duhet të jetë lehtësisht e arritshme për të fikur pajisjen thithëse.

Sinjali i depozitimit (vetëm në pajisjet me kuti komandimi)

Linja e komandimit për sinjalin e raftit është e lidhur nga brenda që më parë dhe është realizuar me një kablo 3-polësh me gjatësi 3 metra. Sistemi i thithjes ndizet duke lidhur telat 1 dhe 3. Linja e komandimit duhet mbërthyer në mënyrën e duhur në një kuti shpërndarëse.



5.4.2. Skema e qarkut



6. Përdorimi


6.1. Funksonimi normal

- 1 Në fillim të ditës së punës, ndizni çelësin kryesor të klinikës ose çelësin kryesor të pajisjes (vetëm në pajisjet me kuti komandimi)*, pajisja ndizet automatikisht.



Tërhiqni tubin e thithjes nga rafti i tubave në njësinë e trajtimit, për të nisur automatikisht procesin e thithjes (vetëm në pajisjet me kuti komandimi).

- 2 Procesi i thithjes ndalon sapo tubi i thithjes vendoset sërish në raftin e tubave (vetëm në pajisjet me kuti komandimi).



- 3 Në përfundim të ditës së punës, fikni çelësin kryesor të klinikës ose çelësin kryesor të pajisjes (vetëm në pajisjet me kuti komandimi)*.




*Në varësi nga situata e montimit, për funksionimin e përditshëm pajisja:

- > Mund të ndizet dhe të fiket direkt në çelësin kryesor
- > Mund të ndizet dhe të fiket në çelësin kryesor të klinikës. Në këtë rast, çelësi i pajisjes është gjithmonë i ndezur dhe furnizimi me energji komandohet në mënyrë qendrore përmes çelësit kryesor të klinikës.
- > Mund të jetë gjithmonë e ndezur dhe gati për përdorim. Kjo nuk sjell asnjë ndikim në pajisje.



RREZIK:

Lidhja e ajrit të shkarkimit mund të jetë e kontaminuar biologjikisht. Përdor doreza!



6.2. Mesazhet e defekteve



Montimi, ndryshimet ose riparimet lejohen të kryhen vetëm nga personeli teknik i autorizuar (shihni pikën 3.2. Udhëzimet e sigurisë)! Për informacione të tjera dhe mbështetje gjatë kryerjes së riparimeve, modernizimeve, analizave të defekteve etj., në dispozicionin tuaj është edhe shërbimi teknik për klientin i kompanisë METASYS!

| Mesazhi i defektit | Shkaku i mundshëm | Veprimet korrigjuese |
|-------------------------------|---|--|
| Pajisja nuk ndizet | Nuk ka furnizim me energji | Kontrolloni tensionin e rrjetit elektrik. Kontrolloni siguresat (siguresa e rrjetit, siguresa në kutinë e komandimit ose në qarkun kryesor). |
| | Tensioni i rrjetit elektrik shumë i dobët | Kontrolloni tensionin e rrjetit elektrik, njoftoni elektricistin nëse nevojitet |
| | Kondensatori me defekt | Matni kapacitetin e kondensatorit dhe ndërrojeni, nëse nevojitet |
| | Sinjali i ndezjes (kontakti i thithjes) (vetëm në pajisjet me kuti komandimi) | Verifikoni sinjalin e ndezjes (kontakti i thithjes) dhe mateni, vendosni sinjalin, nëse nevojitet |
| | Ka vepruar mbrojtja termike në bobinën e motorit | Matni rrymën, verifikoni lëvizjen e lirshme të motorit, lëreni të ftohet - ndizeni nga e para |
| Fuqia e thithjes shumë e ulët | Linja e thithjes nuk është hermetike | Kontrolloni linjën e thithjes për rrjedhje dhe bëni riparimin / ndërrojeni nëse nevojitet. |

7. Kujdesi dhe mirëmbajtja

Për të siguruar jetëgjatësinë e pritshme të shërbimit të pajisjes prej 5 vjetësh, duhet të respektohen kërkesat e specifikuar të instalimit dhe kushtet e funksionimit.

7.1. Mirëmbajtja dhe shërbimi

VAC 1s është një sistem thithjeje që nuk ka nevojë për mirëmbajtje. Për rrjedhojë, nuk ka rekomandime për masat e pastrimit të rregullt ose për punimet e mirëmbajtjes.

8. Nxjerrja jashtë shërbimi

8.1. Çmontimi



PARALAJMËRIM:

Shkëputni burimin e energjisë elektrike përpara çmontimit!



PARALAJMËRIM:

Rrezik kontaminimi: Për të shmangur infektimet, vendosni pajisje mbrojtëse personale (mbrojtje për duart, sytë dhe gojën-hundën) dhe dezinfektoni dhe pastroni pajisjen!

Në rastin e transportit të nevojshëm të kthimit të pajisjes në magazinë ose te METASYS duhet përdorur ambalazhi origjinal i METASYS. Përpara paketimit të pajisjes për ta transportuar te METASYS, duhet që ajo të pastrohet dhe të dezinfektohet. Mbyllni vrimat e mundshme nga ku mund të derdhen lëngjet e mbetura.

8.2. Riciklimi dhe asgjësimi



Ka të ngjarë që pajisja të jetë e kontaminuar! Informoni kompaninë e grumbullimit të mbetjeve për këtë gjë, në mënyrë që të merren masat përkatëse. Pjesët që ekspozohen ndaj amalgamës si rrjetat, filtrat, tubat etj. duhen asgjësuar gjithashtu në përputhje me rregullat e shtetit.

Pjesët plastike jo të kontaminuara të pajisjes mund të dërgohen për riciklimin e plastikës. Komponentët elektronikë të integruar (përfshirë pllakën e qarkut) duhen trajtuar si mbetje elektronike. Pjesët metalike duhen trajtuar si mbetje metalike.

Si alternativë, pajisja mund të kthehet gjithashtu te prodhuesi për asgjësimin e saj sipas rregullave. Përpara paketimit të pajisjes për ta transportuar te METASYS, duhet që ajo të pastrohet dhe të dezinfektohet. Mbyllni vrimat e mundshme nga ku mund të derdhen lëngjet e mbetura. Për dërgesën duhet përdorur ambalazhi origjinal i METASYS.

Për vërtetimin e montimit dhe dokumentacionin e pajisjes ekziston një detyrim për ta ruajtur atë për 5 vjet të tyre pas asgjësimit të pajisjes.


9. Shtojca

9.1. Numrat e porosive dhe qëllimi i dorëzimit

| Numri i porosisë | Emërtimi | Përmbajtja e dërgesës | REF |
|------------------|----------|---|-----------|
| 105000001 | VAC 1s | Pajisja thithëse (gati për instalim) dhe manuali i përdorimit | 105000001 |

9.1.1. Aksesorët, setet e shërbimit, depozita mbledhëse dhe pjesët e këmbimit

| Numri i porosisë | Emërtimi |
|------------------|--|
| 120000514 | Germ filter, Ø 40 mm Connections |
| 120000531 | Pipe silencer |
| 120000053 | ET VAC, connection sleeve Ø 40/32 |
| 120000054 | ET VAC 1s, condensate separator Ø 40 mm |
| 120000055 | ET VAC 1, hose 32x340, condensate separator |
| 120000442 | ET EXCOM hybrid/VAC 1s, control box UK |
| 120000443 | ET EXCOM hybrid/VAC 1s, control box |
| 120000444 | ET EXCOM hybrid/VAC 1s, mounting plate for control box |
| 120000445 | ET EXCOM hybrid/VAC 1s, main pcb board |
| 120000515 | ET EXCOM hybrid 1s/VAC, capacitor, 20 µF |



9.2. Kushtet e garancisë

METASYS ofron për produkte të caktuara një garanci 12-36 muaj (kohëzgjatja e garancisë në varësi të produktit sipas specifikimeve në listën e çmimeve në fuqi). Garancia përfshin të gjitha defektet në materialet, të cilat ndikojnë në funksionimin e pajisjes më shumë sesa vetëm në mënyrë të papërfillshme. Nga detyrimi i garancisë përjashtohen dëmet që shkaktohen nga trajtimi i gabuar ose i parregullt, si dhe konsumimi normal i pajisjes. Përveç kësaj, garancia nuk mbulon ndërrimin e depozitës grumbulluese të amalgamës dhe ajo nuk zbatohet për pjesët që dëmtohen lehtë si xhami, plastika, tubat, filtri, filtri i ujit të kondensuar ose membranat. Garancia nuk përfshin gjithashtu kohët e mundshme të punës dhe të udhëtimit që mund të nevojiten.

Për të përcaktuar vlefshmërinë e garancisë, pas montimit të rregullt duhet që vërtetimi i montimit që shoqëron pajisjen të dërgohet pa vonesë të kompania METASYS. Në këtë rast, afati i periudhës së garancisë fillon nga vënia në punë. Në rastin e instalimit pa dërguar mbrapsht vërtetimin e montimit të kompania METASYS, çdo e drejtë e garancisë bëhet e pavlefshme. Instalimi dhe dërgimi i vërtetimit të montimit duhet kryer brenda 24 muajsh nga data e blerjes nga METASYS.

Çdo e drejtë e kërkesës së garancisë nga klienti bëhet gjithashtu e pavlefshme nëse ndodh vetëm një nga rrethanat e mëposhtme, pavarësisht nëse rrethanat ndodhin në ambientet e METASYS apo të një pronari të mëvonshëm apo të operatorit:

- > Montimi, operimi, mirëmbajtja ose transporti i pajisjes jo në përputhje me rregullat. Në rastin e transportit të nevojshëm të kthimit të pjesëve METASYS duhet përdorur ambalazhi original i METASYS. Përpara paketimit të pajisjes për ta transportuar te METASYS, duhet që ajo të pastrohet dhe dezinfektohet. Mbyllni vrimat e mundshme nga ku mund të derdhen lëngjet e mbetura.
- > Instalimi dhe dërgimi i vërtetimit të montimit nuk kryhet brenda periudhës së përcaktuar kohore prej 24 muajsh.
- > Nuk bëhet përcjellja e vërtetimit të montimit të kompania METASYS.
- > Instalimi dhe përdorimi i pjesëve jo origjinale METASYS.
- > Instalimi i pajisjes nga personel që as nuk është trajnuar dhe as nuk është autorizuar nga METASYS.
- > Shfaqja e dëmeve si rezultat i trajtimit të papërshtatshëm dhe i përdorimit të produkteve të pamiratuara të pastrimit dhe dezinfektimit, shkelja e rregullave të manualit të instruksioneve të përdorimit.
- > Kryerja e riparimeve nga qendrat e paautorizuara të shërbimit ose nga personel i paautorizuar.
- > Mosrespektimi i intervaleve të rekomanduara të mirëmbajtjes. Shërbimet e mirëmbajtjes duhen kryer 11-12 / 23-24 / 35-36 muaj pas montimit të pjesëve përkatëse METASYS.
- > Mungesa e regjistrimit në dokumentacionin e pajisjes e instalimit dhe e serviseve të rekomanduara nga teknikët e trajnuar nga METASYS
- > Mosmarrja e masave të menjëhershme të arsyeshme për shmangien e dëmeve të mëtejshme pas shfaqjes së një defekti.
- > Transportimi i pajisjeve ose i pjesëve të pajisjeve te METASYS pa dokumentacionin e rregullt shoqërues, në veçanti pa përshkrimin e defektit ose pa faturën e blerjes së pajisjes.
- > Mosofrimi i materialeve vizuale (foto, videoklip...) për pjesën METASYS të reklamuar, për rrethanat e montimit, si dhe për mjedisin e montimit të pjesës.

METASYS rezervon të drejtën që në ekzekutimin e kërkesave të garancisë të kërkojë dokumentacionin e pajisjes të ofruar bashkë me pajisjen, për të verifikuar intervalet e mirëmbajtjes. Zbatimi i kërkesave të garancisë bëhet vetëm në mënyrat e mëposhtme:

Në rast defektesh, pajisjet hapen nga teknikët e autorizuar, pjesa e prekur hiqet dhe dërgohet te METASYS e pahapur dhe e pastruar. Klienti e dërgon pajisjen ose komponentin e reklamuar te METASYS me shpenzimet e tij. METASYS verifikon nëse ekziston e drejta e kërkesës së garancisë. METASYS riparon pajisjen ose komponentin, kur kjo është ekonomike. Klienti paguan për shpenzimet e kryera për riparimin, por gjithsesi jo për pjesët e këmbimit që mbulohen nga garancia. Dërgimi i pajisjes ose i komponentit te METASYS përbën në çdo rast një porosi riparimi për METASYS. Në rastet kur periudha e garancisë ka përfunduar apo kur nuk ekziston e drejta e kërkitimit të garancisë, për llogaritjen e kostove për riparimin e pajisjeve të kthyera aplikohet një tarifë trajtimi*. Për inspektimet e mirëfillta të produktit për mallrat e marrë mund të aplikohet një tarifë inspektimi fikse*. Me dërgimin e pajisjes ose të komponentit te METASYS duhet dërguar gjithashtu në çdo rast një përshkrim i defektit me të gjitha informacionet e rëndësishme të pajisjeve. Klienti i METASYS mund të kryejë shërbime përpara kohe vetëm pas konsultimit me METASYS. Duhet dërguar gjithmonë vetëm komponenti i prekur (njësia më e vogël e mundshme). Kur te METASYS dërgohen pjesë të paprekura të pista që nuk kanë nevojë për ndërhyrje teknike, METASYS gëzon të drejtën që t'i shkatërrojë ato pa asnjë dëmshpërblim të veçantë. Pjesa e re që përkon me pjesën e shkatërruar lëvrohet vetëm pas porosisë së veçantë të saj dhe shlyerjes së faturës. METASYS në çdo rast gëzon të drejtën që, në varësi të zgjedhjes së saj, ta ekzekutojë garancinë përmes një note kreditimi ose kthimit të pjesëve të reja, pa kryer asnjë riparim. Shërbimet e ofruara të garancisë nuk kanë efektin e zgjatjes së periudhës së garancisë dhe as nuk fillojnë një periudhe të re garancie. Periudha e garancisë për pjesët e këmbimit të instaluar përfundon me periudhën e garancisë së pajisjes së lëvruar në fillim. Klienti i METASYS ka detyrimin që t'i bëjë të njohur klientit të tij kushtet e garancisë për ekzekutimin e garancisë. Të drejtat ligjore të klientit për garancinë nuk cenohen.

* Kushtet aktuale të garancisë dhe tarifat aktuale gjenden në listën e çmimeve në fuqi të METASYS.

9.3. Historia e ndryshimit

| Rishikimi | Data | Përshkrimi |
|--------------|------------|---|
| ZK-58.211/00 | 08.11.2021 | Krijuar i ri. |
| 200004300v01 | 16.01.2025 | Informacion i shtuar për kontaminimin biologjik dhe jetëgjatësinë. Numrat e porosive u përditësuan. |



protect what you need



METASYS Medizintechnik GmbH

Florianstraße 3 | 6063 Rum bei Innsbruck | Austria

T +43 512 205420 | info@metasys.com | metasys.com

Rezervohet e drejta e gabimeve në printim dhe formulim!